



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-SC-2023-01/CS001

**Vendosi:** Kryetarja e Dhomave të Specializuara  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 12 tetor 2023

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Konfidencial

---

**Vendim mbi Uljen, Modifikimin ose Ndryshimin e Dënimit me  
Shtojca Konfidenciale dhe *Ex Parte***

---

**Ushtruesit të Detyrës së**

**Zëvendësprokurorit të Specializuar:**

Vard Ferdinandse

**Mbrojtjes së Hysni Gucatit:**

Xhonathan Elistan Ris

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke mbajtur parasysh nenin 51(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), rregullat 196 dhe 197 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”) dhe nenet 3, 6 dhe 9-11 të Udhëzuesit të Punës mbi Uljen e Dënimit (“Udhëzuesi i Punës”), pas këshillimeve me gjykatësit e paneleve që dhanë dënimin, lëshon këtë vendim mbi uljen, modifikimin ose ndryshimin e dënimit të z. Hysni Gucati.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 18 maj 2022, Trupi Gjykes II shqiptoi Aktgjykimin në çështjen gjyqësore kundër z. *Hysni Gucati* dhe z. *Nasim Haradinaj*.<sup>1</sup> Trupi Gjykes i shpalli të dy të akuzuarit fajtorë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësim gjatë procedurës penale dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës, dhe i dënoi me një dënim prej katër vjetësh e gjysmë burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim, dhe me një gjobë prej 100 eurosh.<sup>2</sup>

2. Më 2 shkurt 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi Aktgjykimin e Apelit, me të cilin la në fuqi, pjesërisht, verdiktin e fajësisë së z. Guci dhe z. Haradinaj, dhe, me shumicë, uli dënimet e tyre në katër vjet e tre muaj burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.<sup>3</sup> Paneli i Apelit gjithashtu la në fuqi për secilin prej tyre dënimin shtesë me një gjobë prej 100 eurosh.<sup>4</sup>

3. Më 5 korrik 2023, në përputhje me nenin 3(3) të Udhëzuesit të Punës, Administratorja njoftoi Kryetaren se z. Gucati do ta plotësonte kriterin për shqyrtim

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-07, F00611/RED, Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit, 18 maj 2022.

<sup>2</sup> Aktgjykimi, para. 1012-1017.

<sup>3</sup> KSC-CA-2022-01, F00114, Aktgjykimi i Apelit, 2 shkurt 2023, para. 442.

<sup>4</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 442.

për ulje të dënimit më 25 korrik 2023, kur do të kishte vuajtur dy të tretat e dënimit.<sup>5</sup>

4. Më 26 korrik 2023, Kryetarja i kërkoi Administratores të mblidhte dhe t'i dorëzonte informacionin e përcaktuar në rregullën 196(3) të Rregullores, si dhe të ndërmernte hapat e paraparë në nenin 4 të Udhëzuesit të Punës.<sup>6</sup>

5. Më 14 gusht 2023, Administratorja i dorëzoi Kryetares informacionin e mbledhur sipas rregullës 196(3) të Rregullores dhe nenit 5(1) të Udhëzuesit të Punës.<sup>7</sup> Konkretisht, Administratorja dorëzoi: (i) raportin e Njesisë së Paraburgimit ("NJP" dhe "Raporti i NJP-së"); (ii) raportin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS" dhe "Raporti i ZPS-së"); dhe (iii) parashtrimet e vetë Administratores ("Parashtrimet e Administratores").

6. Më 28 gusht 2023, përmes Njesisë për Administrimin e Gjykatës, z. Gucati dorëzoi vërejtjet e veta në lidhje me parashtrimet e Administratores dhe raportet përkatëse ("Parashtrimet e Gucatit").<sup>8</sup>

7. Më 30 gusht 2023, në përputhje me nenin 51(2) të Ligjit, rregullën 196(1) të Rregullores dhe nenin 6 të Udhëzuesit të Punës, informacionin e marrë Kryetarja ua dorëzoi gjykatësve të paneleve që dhanë dënimin dhe u kërkoi të jepnin mendimet e tyre në lidhje me uljen e dënimit të z. Gucati.

8. Më 28 shtator 2023, Kryetarja mbajti seancë gjatë së cilës dëgjoi mendimet e z. Gucati mbi uljen, modifikimin ose ndryshimin e dënimit dhe përgjigjet e tij ndaj pyetjeve që i drejtoi.

---

<sup>5</sup> KSC/REG/IOR/6207, Njoftim në lidhje me Plotësimin e Kriterit për Shqyrtim për Ulje të Dënimit, 5 korrik 2023 (konfidencial).

<sup>6</sup> KSC/CHA/PRE/0818, Njoftim në lidhje me Plotësimin e Kriterit për Shqyrtim për Ulje të Dënimeve të z. Gucati dhe z. Haradinaj, nr. KSC-SC-2023-01/CS001, 26 korrik 2023 (konfidencial).

<sup>7</sup> KSC/REG/IOR/6296, Informacioni i Kërkuar sipas Nenit 5 të Udhëzuesit të Punës mbi Uljen e Dënimit në lidhje me z. Hysni Gucati, 14 gusht 2023 (konfidencial).

<sup>8</sup> Parashtrime me Shkrim të Gucatit në lidhje me Uljen e Dënimit sipas Nenit 5(3) të Udhëzuesit të Punës mbi Uljen e Dënimit KSC-BD-48, 28 gusht 2023 (konfidenciale).

## II. ANALIZË

9. Fillimisht, Kryetarja thekson se personat e dënuar nga Dhomat e Specializuara e plotësojnë kriterin për *shqyrtim* për ulje të dënimit pasi të kenë vuajtur dy të tretat e dënimit.<sup>9</sup> Plotësimi i kriterit do të thotë shqyrtim dhe jo e drejtë e vetvetishme për ulje të dënimit pas vuajtjes së dy të tretave të tij. Rrjedhimisht, Kryetarja nuk ka “detyrimin e provës”, sikurse sugjeron z. Gucati, për të demonstruar se ai “nuk e ka plotësuar kriterin për lirimin me kushte”.<sup>10</sup>

10. Kryetarja thekson se në bazë të Ligjit, Rregullores dhe Udhëzuesit të Punës, ajo ka kompetencë për të shqyrtuar vetëm plotësimin e kriterit për shqyrtim për ulje, modifikim ose ndryshim të dënimit të personit të dënuar, dhe jo të aktgjykimeve të lëshuara nga panelet kompetente.

11. Gjithashtu, Kryetarja mban parasysh mendimet e gjykatësve të paneleve që dhanë dënimin, edhe pse nuk do të merret me analizën e tyre në vendimin e vet. Kryetarja do t'i marrë në shqyrtim faktorët e përcaktuar në rregullën 196(3) të Rregullores dhe do të vendosë, mbi bazën e fakteve të çështjes, nëse ekzistojnë faktorë të mjaftueshëm që përlligjin uljen, modifikimin ose ndryshimin e dënimit të z. Gucati.

a) Distancim i njëmendtë prej veprës penale

12. Në Aktgjykimin e vet, Trupi gjykues konstatoi se z. Gucati “nuk tregoi pendesë për veprimet e tij dhe u betua në mënyrë të përsëritur se do t'i kryente sërish këto veprime në të ardhmen”.<sup>11</sup> Trupi Gjykues gjithashtu mori parasysh dëshminë e z. Gucati, ku ai deklaroi:

Z. Gucati: “Thashë s’jam tuj u frigu prej as punës time ça kam bo. Unë e thashë, çdo dokumentacion që vjen në zyrën time, në dëm të vendit tim, unë do ta bëj publike”.<sup>12</sup>

<sup>9</sup> Shih rregullën 196(2) të Rregullores; neni 3(1) i Udhëzuesit të Punës.

<sup>10</sup> Parashtrimet e Gucatit, para. 3, 13 (f. 2, 4).

<sup>11</sup> Aktgjykimi, para. 976.

<sup>12</sup> Aktgjykimi, para. 976, poshtëshënimi 2010, i referohet transkriptit të seancës, 6 dhjetor 2021, f. 2222.

(...)

Përfaqësuesi i ZPS-së: “A jeni penduar, keni pendesë për veprimet për të cilat jeni nxjerrë përpara gjyqit?”

z. Gucati: “Deri më ditën e sodit, për 54 vite të miat që jam dhe mbi 30 që punoj, nuk e di që jam i penduar në ndonjë punë. Pendohna aty ku gaboj me qëllim. Kërkoj falje. Aty ku unë e di që s’kam bë gabimin, nuk kam nevojë të kërkoj falje se këto dokumentacione unë nuk i kam vjedhë dhe nuk i kam pru në Organizatën e Veteranëve të Luftës. Po t’i kisha vjedhur unë këto dokumentacione, publikisht do të kërkoja falje për hajninë që e kam bë. Unë hajni s’kam bërë dhe unë s’kam fyer asnjë njeri, asnjë dëshmitar, asnjë deklaratë s’e kam lexuar. Dhe kështu, nuk kam arsye që të kërkoj falje përderisa unë s’kam vjedhë dhe s’kam thy kërkënd shpirtnisht”.

Përfaqësuesi ZPS-së: “A do ta bënit po të njëjtën?”

z. Gucati: “Unë jam deklaruar edhe ma herët dhe ditën e djeshme dhe të pardjeshme jam deklaruar, e nderuara. Unë s’jam gardian i askujt, asnjë institucioni në vendin tim ma së pari, po as në Hagë, këtu në Holandë. Unë ruaj zyrat e mia ku unë punoj unë. Jam gardian i asaj pune ku jam i thirrur. Kështu që unë ju kisha bë lutje mos na provokoni me dokumentacione”.<sup>13</sup>

13. Në parashtrimet me shkrim, z. Gucati argumenton se “prania apo mungesa e pendesës nuk përfshihet në faktorët relevantë” për vlerësimin nëse duhet të miratohet ose jo ulje e dënimit.<sup>14</sup> Rrjedhimisht, në parashtrimet me shkrim ai nuk paraqet informacion lidhur me distancimin nga veprat penale për të cilat u dënua.<sup>15</sup> Në vend të kësaj, z. Gucati pretendon se është distancuar nga vepra penale “në kuptimin që nuk synon të ndër marrë hapa të mëtejshëm për të kundërshtuar Dhomat e Specializuara, as në praktikë dhe as në parim”.<sup>16</sup>

14. Administratorja parashtron se nuk është raportuar që z. Gucati t’u ketë shprehur punonjësve të NJP-së pendesë apo keqardhje për veprat penale për të cilat u dënua.<sup>17</sup> Në Raportin e NJP-së theksohet se z. Gucati e kupton pse u shpall fajtor dhe arsyen pse mbahet në burg, edhe pse me punonjësit e NJP-së nuk bën biseda në

---

<sup>13</sup> Aktgjykimi, para. 976, poshtëshënimi 2010, i referohet transkriptit të seancës, 8 dhjetor 2021, f. 2401.

<sup>14</sup> Parashtrimet e Gucatit, para. 7 (f. 3).

<sup>15</sup> Shih në përgjithësi Parashtrimet e Gucatit.

<sup>16</sup> Parashtrimet e Gucatit, para. 31 (f. 8).

<sup>17</sup> Parashtrimet e Administratores, para. 34. Shih gjithashtu Raportin e NJP-së, para. 8.

lidhje me çështjen e tij apo për veprat penale për të cilat është dënuar.<sup>18</sup>

15. ZPS-ja parashtron se me sa e ka kuptuar, gjatë kohës që ndodhet në burg, z. Gucati nuk ka thënë dhe nuk ka bërë asgjë që do të sugjeronte distancim të njëmendte nga veprat penale që kreu.<sup>19</sup>

16. Gjatë seancës, z. Gucati theksoi se për të “e kalumja është e mbyllur” dhe se nuk ka pasur kurrë për qëllim të frikësojë apo kërcënojë dikë.<sup>20</sup> Z. Gucati deklaroi se është “në gjendje t’i kërkojë falje” kujtdo që mund të jetë ndier i kërcënuar apo i frikësuar nga veprimet e tij.<sup>21</sup> Z. Gucati deklaroi se ka ndërmend të përqendrohet në të ardhmen, nënën, e cila është në fund të jetës, dhe fëmijët e vet.<sup>22</sup>

17. Kryetarja është në dijeni se z. Gucati nuk pranoi të shprehte pendesë gjatë procesit kundër tij, sikurse theksoi edhe Trupi Gjykses. Edhe pas vuajtjes së dy të tretave të dënimit, ai prapëseprapë nuk paraqiti mendime për pendesë të mundshme në parashtrimet e veta me shkrim.

18. Megjithatë, gjatë seancës, z. Gucati diskutoi se si ndjehej për veprat penale për të cilat u dënua dhe shprehu njëfarë pendese dhe keqardhjeje për veprimet e veta.<sup>23</sup> Kryetarja gjykon se pendesa e shprehur ishte e njëmendë dhe konstaton se kjo tregon që ai e ka shfrytëzuar kohën e kaluar në burg për të reflektuar për sjelljen e vet dhe ka vendosur të distancohet nga veprimet e veta në të kaluarën.

19. Rrjedhimisht, Kryetarja konstaton se ky faktor shkon në favor të uljes, modifikimit ose ndryshimit të mundshëm të dënimit të z. Gucati.

#### b) Shenja të rehabilitimit

---

<sup>18</sup> Raporti i NJP-së, para. 8.

<sup>19</sup> Raporti i ZPS-së, para. 3.

<sup>20</sup> Transkripti i seancës, 28 shtator 2023, f. 5.

<sup>21</sup> Transkripti i seancës, 28 shtator 2023, f. 6.

<sup>22</sup> Transkripti i seancës, 28 shtator 2023, f. 6.

<sup>23</sup> Transkripti i seancës, 28 shtator 2023, f. 6-7.

20. Z. Gucati parashtron se u është përmbajtur plotësisht Rregullores së Paraburgimit dhe udhëzimeve të punonjësve të Njesisë së Paraburgimit. Ai gjithashtu argumenton se është sjellë “me respekt, përgjegjësi dhe në mënyrën e duhur gjatë gjithë kohës së burgimit”.<sup>24</sup> Z. Gucati nuk pajtohet me vlerësimin e Administratores se vendimi i tij që të mos i përgjigjej pyetjes nëse do ta kishte bërë sërish të njëjtën gjë përbënte “betim se do t’i kryente sërish këto veprime në të ardhmen”.<sup>25</sup>

21. Z. Gucati gjithashtu pretendon se “nuk ka ndërmend të ndërmarrë hapa të mëtejshëm për të kundërshtuar Dhomat e Specializuara dhe do të vazhdojë t’u përmbahet të gjitha kushteve që do t’i caktohen për lirim (sikurse ka vepruar që kur është arrestuar)”.<sup>26</sup> Z. Gucati pajtohet se Dhomat e Specializuara “janë më se të konsoliduara dhe funksionojnë. [Z.] Gucati e kupton realitetin se, si ekzistenca e Dhomave të Specializuara, ashtu edhe ecuria e punës së tyre, janë të pakthyeshme”.<sup>27</sup>

22. Z. Gucati pohon se aktualisht nuk synon të rimarrë ndonjë rol në Organizatën e Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e as nuk synon të kërkojë vëmendjen e mediave në lidhje me kundërshtimin e Dhomave të Specializuara apo kohën e kaluar në burgim.<sup>28</sup>

23. Administratorja parashtron se z. Gucati nuk ka demonstruar se do të përfshihej sërish në sjellje të ngjashme.<sup>29</sup> Sipas Raportit të NJP-së, z. Gucati ka treguar sjellje miqësore, të përgjegjshme dhe respektuese ndaj punonjësve që nga mbërritja e tij në objektin e paraburgimit.<sup>30</sup> Në Raportin e NJP-së thuhet se z. Gucati nuk është përfshirë në ndonjë veprim të papërshtatshëm dhe nuk ka shfaqur sjellje agresive, verbale apo

---

<sup>24</sup> Parashtrimet e Gucatit, para. 2 (f. 1).

<sup>25</sup> Parashtrimet e Gucatit, para. 23 (f. 6).

<sup>26</sup> Parashtrimet e Gucatit, para. 5, 21, 24, 27 (f. 2, 6-7).

<sup>27</sup> Parashtrimet e Gucatit, para. 22, 25, 28 (f. 6-7).

<sup>28</sup> Parashtrimet e Gucatit, para. 19-20 (f. 5-6).

<sup>29</sup> Parashtrimet e Gucatit, para. 34 (f. 8-9). Shih gjithashtu Raportin e NJP-së, para. 8.

<sup>30</sup> Raporti i NJP-së, para. 9. Shih gjithashtu Raportin e NJP-së, para. 10-12, 15, 21-22.



të ndonjë forme tjetër.<sup>31</sup> Në Raportin e NJP-së gjithashtu theksohet se z. Gucati u është përmbajtur plotësisht Rregullores së Paraburgimit dhe udhëzimeve të dhëna nga punonjësit.<sup>32</sup>

24. Sipas ZPS-së, nuk ka asnjë informacion të disponueshëm që sugjeron se z. Gucati ka bërë ndonjë veprim që mund të cilësohet si rehabilitim.<sup>33</sup> ZPS-ja gjithashtu pretendon se z. Gucati vazhdoi me sjellje penale pavarësisht nga tre urdhrat dhe kërkesat e ZPS-së për të ndaluar shpërndarjen e mëtejshme të informacionit konfidencial, dhe se z. Gucati është "qartësisht i vendosur të përsërisë veprimet [e tij] në të ardhmen."<sup>34</sup>

25. Gjatë seancës, z. Gucati u shpreh se e kaluara e tij është e kaluar dhe e mbyllur, dhe se tani do të mendojë vetëm për të ardhmen e tij dhe të familjes.<sup>35</sup> Z. Gucati ritheksoi se nuk ka ndërmend të pengojë drejtësinë në asnjë mënyrë, dhe as të jetë pengesë për drejtësi.<sup>36</sup> Z. Gucati gjithashtu konfirmoi se nuk do të pengojë asnjë njeri për të dhënë dëshmi para Dhomave të Specializuara në të ardhmen.<sup>37</sup>

26. Kryetarja vëren se z. Gucati i ka respektuar të gjitha rregullat dhe rregulloret gjatë paraburgimit të tij në objektin e paraburgimit, është sjellë mirë dhe me respekt ndaj punonjësve të NJP-së dhe të paraburgosurve të tjerë dhe ka deklaruar se ka ndërmend të përqendrohet te vetja dhe familja në të ardhmen. Kryetarja gjithashtu thekson se z. Gucati është zotuar shprehimisht se nuk do të përfshihet në asnjë lloj sjelljeje që Dhomat e Specializuara mund ta cilësojnë si pengim të drejtësisë.

27. Për këto arsye, Kryetarja gjykon se z. Gucati ka treguar shenja të qarta

---

<sup>31</sup> Raporti i NJP-së, para. 9. Shih gjithashtu Raportin e NJP-së, para. 16-19.

<sup>32</sup> Raporti i NJP-së, para. 13. Shih gjithashtu Raportin e NJP-së, para. 14-15, 20.

<sup>33</sup> Raporti i ZPS-së, para. 6.

<sup>34</sup> Raporti i ZPS-së, para. 5.

<sup>35</sup> Transkripti i seancës, 28 shtator 2023, f. 5, 7.

<sup>36</sup> Transkripti i seancës, 28 shtator 2023, f. 7.

<sup>37</sup> Transkripti i seancës, 28 shtator 2023, f. 8.



rehabilitimi dhe konstaton se ky faktor shkon në favor të uljes, modifikimit ose ndryshimit të mundshëm të dënimit z. Gucati.

c) Gjasat e rishoqërimit dhe riintegritit të suksesshëm

28. Z. Gucati parashtron se ka lidhje familjare të mira dhe mjedis të qëndrueshëm jetese, që tregon gjasat e rishoqërimit dhe riintegritit të suksesshëm pas lirimit të tij.<sup>38</sup> Z. Gucati parashtron se ky faktor peshon “qartësisht” në favor të uljes së dënimit të tij.<sup>39</sup>

29. Në Raportin e NJP-së konfirmohet se z. Gucati ka një lidhje të qëndrueshme me familjen dhe një rrjet të gjerë shoqëror, që mund të mbështesë kthimin dhe rishoqërimitin e tij pas lirimit.<sup>40</sup>

30. ZPS-ja argumenton se çdo shqyrtim i rishoqërimit apo riintegritit të suksesshëm të z. Gucati kushtëzohet prej refuzimit të tij për të kryer sërish vepra penale “kundër kësaj Gjykate dhe dëshmitarëve të saj”.<sup>41</sup> Sipas ZPS-së, fakti që z. Gucati qartë dhe në mënyrë të përsëritur është përbetuar se do të vazhdojë me kryerjen e veprave sugjeron se ai nuk mund të riintegrohet me sukses në shoqëri.<sup>42</sup>

31. Kryetarja është e mendimit se lidhjet e ngushta të z. Gucati me familjen dhe rrjeti shoqëror që ka, me gjasë do ta ndihmojnë në përshtatjen dhe integrimin e tij kur të kthehet në Kosovë pas lirimit. Gjatë seancës, z. Gucati theksoi sa e rëndësishme është familja për të.<sup>43</sup> Kryetarja vlerëson se shqetësimet që ngre ZPS-ja janë më shumë relevante për rehabilitimin dhe distancimin, sesa për aftësinë e z. Gucati për t'u riintegruar në shoqëri pas lirimit.

---

<sup>38</sup> Parashtrimet e Gucatit, para. 4 (f. 1).

<sup>39</sup> Parashtrimet e Gucatit, para. 30 (f. 8).

<sup>40</sup> Raporti i NJP-së, para. 24. Shih gjithashtu Raportin e NJP-së, para. 25-26.

<sup>41</sup> Raporti i ZPS-së, para. 7.

<sup>42</sup> Raporti i ZPS-së, para. 7.

<sup>43</sup> Transkripti i seancës, 28 shtator 2023, f. 10.

32. Bazuar në sa më lart, Kryetarja i konsideron lidhjet e z. Gucati me familjen si faktor pozitiv për vlerësimin nëse z. Gucati do t'i miratohet ulje, modifikim ose ndryshim i dënimit.

d) Pesha e veprave penale për të cilat personi është dënuar

33. Z. Gucati parashtron se, megjithëse pesha e veprës penale përfshihet në rregullën 196(3) të Rregullores, ajo parimisht nuk duhet të jetë faktor që peshon në favor të uljes së dënimit, ose kundër saj.<sup>44</sup> Përkundrazi, z. Gucati parashtron se pesha e veprës penale "është pjesë përbërëse dhe e detyrueshme e dënimit fillestar të shqiptuar dhe përcakton kohën që duhet të kalohet në burg përpara se të jetë plotësuar kriteri për shqyrtim për lirim të parakohshëm".<sup>45</sup>

34. Kur shqiptoi Aktgjykimin, Kryegjykatësi i Trupit Gjykues theksoi:

Kjo çështje është e rëndësishme, sepse pasqyron vetë arsyen pse u krijuan Dhomat e Specializuara. Kjo çështje ka të bëjë me administrimin e duhur të drejtësisë, integritetin dhe sigurinë e proceseve gjyqësore dhe, çka është më e rëndësishme, sigurinë, mirëqenien dhe çlirimin nga frika të qindra personave, të cilët janë paraqitur për të përmbushur detyrën e tyre qytetare si dëshmitarë. Mbrojtja e tyre nga frikësimi dhe dëmtimi qëndron në themelin e çdo sistemi të drejtësisë penale, qoftë ai vendor apo ndërkombëtar. Pa dëshmitarë, nuk mund të ketë drejtësi për viktimat apo për shoqërinë në përgjithësi. Veprimet dhe sjellja e të akuzuarve sfiduan pikërisht këtë themel.<sup>46</sup>

35. Paneli i Gjykatës së Apelit theksoi:

Lloji i krimeve që përfshihen në juridiksionin e Dhomave të Specializuara dhe konteksti në të cilin u kryen ato, bëjnë të nevojshme mbështetjen në dëshmitë gojore. Është me rëndësi themelore për përmbushjen e misionit të Dhomave të Specializuara që individët të cilët vijnë për të dhënë dëshmi, shpesh për përvoja traumatike ose të vështira, ta bëjnë këtë pa pasur frikë. Mbrojtja e dëshmitarëve nga frikësimi dhe dëmtimi është në themel të çdo sistemi të drejtësisë penale, përfshirë edhe në Dhomat e Specializuara. Rrjedhimisht, kjo çështje gjyqësore ka të bëjë me administrimin e duhur të drejtësisë, integritetin dhe sigurinë e procesit dhe sigurinë e dëshmitarëve.<sup>47</sup>

---

<sup>44</sup> Parashtrimet e Gucatit, para. 8 (f. 3). Parashtrimet e Gucatit, para. 33 (f. 8).

<sup>45</sup> Parashtrimet e Gucatit, para. 8 (f. 3). Shih gjithashtu Parashtrimet e Gucatit, para. 32 (f. 8).

<sup>46</sup> KSC-BC-2020-07, Përmbledhja e Aktgjykimit, 18 maj 2022.

<sup>47</sup> KSC-CA-2022-01, Përmbledhja e Aktgjykimit të Apelit, 2 shkurt 2023.

36. ZPS-ja parashtron se, sikurse theksohet në Aktgjykimin e Trupit Gjykues dhe në Aktgjykimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, veprat penale për të cilat z. Gucati u dënua janë “padyshim të rënda” dhe nuk favorizojnë ulje të dënimit.<sup>48</sup>

37. Kryetarja vëren se sjellja e z. Gucati pati ndikim mjaft negativ mbi dëshmitarët që mund të paraqiten para Dhomave të Specializuara dhe aftësinë e Gjykatës për të realizuar mandatin e vet. Kryetarja gjithashtu mban parasysht konstatimet e Trupit Gjykues dhe të Panelit të Gjykatës së Apelit kur është fjala për peshën e veprave penale dhe ndikimin që ka pasur sjellja e z. Gucati mbi integritetin dhe funksionimin e Dhomave të Specializuara dhe të ZPS-së.

38. Rrjedhimisht, Kryetarja konstaton se ky faktor peshon kundër uljes së dënimit të z. Gucati.

e) Trajtimi i të burgosurve të tjerë në rrethana të ngjashme

39. Z. Gucati argumenton se një i burgosur tjetër në rrethana të ngjashme brenda sistemit në Kosovë – domethënë, një person i dënuar me pesë ose më pak vjet burgim – do ta kishte plotësuar kriterin për shqyrtim për lirim pas vuajtjes së vetëm gjysmës së dënimit.<sup>49</sup>

40. Në Raportin e NJP-së thuhet se z. Gucati dhe z. Haradinaj janë personat e parë të dënuar nga Dhomat e Specializuara që kanë vuajtur tashmë dy të tretat e dënimeve të tyre.<sup>50</sup> Rrjedhimisht, nuk ka raste të tjera të të burgosurve në rrethana të ngjashme.<sup>51</sup>

41. ZPS-ja parashtron se veprat penale që kreu z. Gucati “janë të llojit dhe shkallës që nuk mund të krahasohen me të tjerë që kanë kryer vepra penale të ngjashme në tribunalë të tjerë”.<sup>52</sup> ZPS-ja po ashtu argumenton se z. Gucati, bashkë me z. Haradinaj,

---

<sup>48</sup> Raporti i ZPS-së, para. 10. Shih gjithashtu Raportin e ZPS-së, para. 8-9.

<sup>49</sup> Parashtrimet e Gucatit, para. 29 (f. 7). Shih gjithashtu Parashtrimet e Gucatit, para. 34 (f. 8-9).

<sup>50</sup> Raporti i NJP-së, para. 27.

<sup>51</sup> Raporti i NJP-së, para. 27.

<sup>52</sup> Raporti i ZPS-së, para. 11.

janë deri më sot të vetmit persona të dënuar nga Dhomat e Specializuara për vepra penale në bazë të Kodit Penal të Kosovës, “çka e bën edhe më të ndërlikuar krahasimin e duhur [me] [të burgosur të tjerë në rrethana të ngjashme]’”.<sup>53</sup>

42. Kryetarja thekson, sikurse theksohet edhe në Raportin e NJP-së, se ky është rasti i parë që persona të dënuar nga Dhomat e Specializuara kanë vuajtur dy të tretat e dënimeve të tyre. Për këtë arsye, nuk ka të burgosur të tjerë në rrethana të ngjashme dhe Kryetarja e gjykon këtë si faktor neutral në vlerësimin e uljes, modifikimit ose ndryshimit të dënimit të z. Gucati.

f) A do të shkaktonte lirimi paqëndrueshmëri shoqërore të konsiderueshme

43. Z. Gucati argumenton se gjasa që lirimi i tij të shkaktojë paqëndrueshmëri shoqërore të konsiderueshme vlerësohet të jetë “shumë e vogël”.<sup>54</sup> Z. Gucati gjithashtu parashtron se ky faktor “qartësisht” shkon në favor të uljes së dënimit të tij.<sup>55</sup>

44. Administratorja parashtron se sipas vlerësimit të kryer nga Njësia e Sigurisë (“NJS”), lirimi i z. Gucati do të shkaktojë një reagim publik fillestar, dhe ka të ngjarë të reklamohet nga Organizata e Veteranëve të Luftës e Kosovës si një lloj “kthimi i fitimtarit”.<sup>56</sup> NJS-ja thekson se sidoqoftë, gjasa që lirimi i z. Gucati të shkaktojë një nivel të tillë trazirash civile që mund të konsiderohet paqëndrueshmëri shoqërore e konsiderueshme, pritet të jetë shumë e vogël.<sup>57</sup> Gjithashtu, NJS-ja thekson se nuk parashikohet që lirimi i z. Gucati të rrisë rrezikun për sigurinë e tij personale.<sup>58</sup>

45. ZPS-ja parashtron se z. Gucati “i përshkroi dëshmitarët (e mundshëm) si

---

<sup>53</sup> Raporti i ZPS-së, para. 11.

<sup>54</sup> Parashtrimet e Gucatit, para. 3 (f. 1).

<sup>55</sup> Parashtrimet e Gucatit, para. 30 (f. 8).

<sup>56</sup> Parashtrimet e Administratores, para. 16.

<sup>57</sup> Parashtrimet e Administratores, para. 16. Shih gjithashtu Parashtrimet e Administratores, para. 17-21, 23.

<sup>58</sup> Parashtrimet e Administratores, para. 22.

tradhtarë, spiunë, bashkëpunëtorë, kriminelë dhe gjakpirës” dhe se këto fjalë u thanë në kontekst të asaj që Trupi Gjykses e karakterizoi si “atmosferë mbizotëruese e frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë”.<sup>59</sup> Sipas ZPS-së, ka arsye për të besuar se lirimi i z. Gucati do të shkaktonte paqëndrueshmëri shoqërore të konsiderueshme, “së paku brenda komunitetit të personave të cilët kanë bashkëpunuar dhe/ose konsiderohen se kanë bashkëpunuar me ZPS”.<sup>60</sup>

46. Pasi ka shqyrtuar informacionin që i është paraqitur, Kryetarja vlerëson se rreziku që lirimi i Gucati të shkaktojë paqëndrueshmëri shoqërore të konsiderueshme në Kosovë është i ulët. Megjithëse mund të ketë njëfarë frike dhe shqetësimi në viktima ose dëshmitarë të mundshëm që mund të paraqiten para Dhomave të Specializuara në të ardhmen, kjo nuk mjafton për të konstatuar se lirimi i z. Gucati do të shkaktojë paqëndrueshmëri shoqërore sipas rregullës 196(3)(f) të Rregullores. Kryetarja thekson se NJS-ja kreu një vlerësim rrënjësor të rrezikut në lidhje me këtë aspekt, të cilit Kryetarja i kushton rëndësi të konsiderueshme.

47. Kryetarja rrjedhimisht gjykon se ky faktor peshon në favor të uljes, modifikimit ose ndryshimit të mundshëm të dënimit të z. Gucati.

g) A ka pasur bashkëpunim të konsiderueshëm me ZPS-në

48. ZPS-ja pretendon se nuk ka pasur bashkëpunim, e aq më pak bashkëpunim të konsiderueshëm të z. Gucati me ZPS-në.<sup>61</sup>

49. Kryetarja vëren se nuk ka asnjë tregues që ZPS-ja të ketë kërkuar ndonjëherë bashkëpunim prej z. Gucati. Rrjedhimisht, Kryetarja e konsideron këtë si faktor neutral në vlerësimin nëse z. Gucati do t'i miratohet ulje, modifikim ose ndryshim i dënimit.

---

<sup>59</sup> Raporti i ZPS-së, para. 12.

<sup>60</sup> Raporti i ZPS-së, para. 12.

<sup>61</sup> Raporti i ZPS-së, para. 13.

h) Ndhurma e dhënë vullnetarisht nga personi i dënuar për të mundësuar zbatimin e aktgjykimeve dhe urdhrave të Dhomave të Specializuara

50. Administratorja parashtron se aktgjykimi kundër z. Gucati dhe z. Haradinaj është i pari Aktgjykim i shpallur në Dhomat e Specializuara, vijuar nga aktgjykimi në procesin kundër z. Salih Mustafa.<sup>62</sup> Administratorja gjithashtu parashtron se nuk ka informacion lidhur me ndonjë ndihmë të dhënë vullnetarisht nga z. Gucati për të mundësuar zbatimin e aktgjykimeve të Dhomave të Specializuara dhe urdhrave në çështje të tjera gjyqësore.<sup>63</sup>

51. ZPS-ja parashtron se z. Gucati nuk ka dhënë vullnetarisht ndihmë dhe se logjikisht as nuk mund të pritej nga ai që ta bënte këtë.<sup>64</sup>

52. Për mendimin e Kryetares, logjikisht nuk mund të pritet që z. Gucati të ketë dhënë vullnetarisht ndihmë në lidhje me zbatimin e vendimeve dhe urdhrave të Dhomave të Specializuara, e as nuk ishte realisht në gjendje ta bënte këtë.

53. Rrjedhimisht, Kryetarja e konsideron këtë si faktor neutral në vlerësimin e uljes, modifikimit ose ndryshimit të dënimit të z. Gucati.

i) Veprime të qenësishme të ndërmarra nga i dënuari në të mirë të viktimave, si dhe pasojat për viktimat dhe familjet e tyre në rast të uljes, modifikimit ose ndryshimit të dënimit.

54. Kryetarja vëren se nuk kishte viktimë pjesëmarrëse në procesin kundër z. Gucati. Rrjedhimisht, Kryetarja e konsideron këtë si faktor neutral në vlerësimin e uljes, modifikimit ose ndryshimit të dënimit të z. Gucati.

j) Rrethanat personale të personit të dënuar

---

<sup>62</sup> Parashtrimet e Administratores, para. 24.

<sup>63</sup> Parashtrimet e Administratores, para. 25.

<sup>64</sup> Raporti i ZPS-së, para. 14.

55. Në Raportin e NJP-së theksohet se z. Gucati kohët e fundit ka kaluar një operacion ortopedik për trajtimin e një gjendjeje kronike pastraumatike në ijën e tij të djathtë, dhe po vazhdon shërimin. Sipas Raportit të NJP-së, nuk ka shqetësime të tjera të njohura në lidhje me gjendjen shëndetësore të z. Gucati.<sup>65</sup>

56. Kryetarja rikujton lidhjet e ngushta të z. Gucati me familjen dhe mban parasysh vështirësitë me të cilat ai përballet për shkak të qenit larg familjes, përfshirë dhe nënës, e cila është në gjendje të rëndë shëndetësore. Kryetarja gjykon se ky faktor peshon në favor të uljes, modifikimit ose ndryshimit të mundshëm të dënimit të z. Gucati.

k) Faktorë të tjerë që vërtetojnë ndryshim të qartë dhe të konsiderueshëm të rrethanave, të mjaftueshëm për të përligjur uljen, modifikimin ose ndryshimin e dënimit

57. ZPS-ja argumenton se që nga Aktgjykimi i Apelit në këtë çështje gjyqësore, kanë filluar gjykimet kundër *Pjetër Shalës dhe Hashim Thaçit dhe të tjerëve*, në të cilat kanë dëshmuar tashmë disa dëshmitarë të ZPS-së.<sup>66</sup> ZPS-ja parashtron se edhe shumë dëshmitarë të tjerë janë planifikuar të dëshmojnë në çështjen *Thaçi dhe të tjerët*, çka është edhe një arsye më shumë për të siguruar që z. Gucati të vuajë dënimin e plotë “sepse kjo do të thotë se [ai] do të vazhdojë të mbahet në burg ndërsa Gjykata të dëgjojë dëshmi të rëndësishme”.<sup>67</sup>

58. Kryetarja nuk bindet nga parashtrimet e ZPS-së se ulja, modifikimi ose ndryshimi i dënimit të z. Gucati duhet të kushtëzohet nga dëshmitë që janë duke u dhënë në procese të tjera. Kryetarja vëren se ZPS-ja nuk shpjegon pse z. Gucati duhet të mbetet në burg derisa të paraqiten provat në çështjet e tjera gjyqësore, dhe thekson se procesi kundër *Hashim Thaçit dhe të tjerëve* do të vazhdojë edhe pasi z. Gucati të ketë vuajtur të gjithë dënimin. Nëse parashtrimi i ZPS-së mund të interpretohet si frikë se

---

<sup>65</sup> Raporti i NJP-së, Shtojca A.

<sup>66</sup> Raporti i ZPS-së, para. 15.

<sup>67</sup> Raporti i ZPS-së, para. 15.



z. Gucati do të kryejë sërish vepra penale gjatë kohës që Trupi Gjykses përkatës po dëgjon dëshmi të rëndësishme në procese gjyqësore të tjera, Kryetarja thekson se i mori parasysh deklaratat e z. Gucati në lidhje me këtë kur vlerësoi shkallën e mundshme të rehabilitimit të tij.<sup>68</sup> Rrjedhimisht, Kryetarja nuk do ta shqyrtojë sërish këtë faktor.

### III. ULJA E DËNIMIT

59. Kryetarja thekson se sipas nenit 51(2) të Ligjit, personi i dënuar i plotëson kriteret për ulje të dënimit pasi të ketë vuajtur dy të tretat e dënimit.

60. Kryetarja rikujton se z. Gucati ka demonstruar shenja pozitive të distancimit nga veprat penale për të cilat u dënua, ka shprehur synimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, dhe ka treguar sjellje pozitive gjatë kohës së paraburgimit në objektin e paraburgimit. Sidoqoftë, veprat penale për të cilat u dënua janë të rënda dhe përfshijnë vendime fajësie për shpërfillje të urdhrave të qartë për mosshpërndarjen e mëtejshme të informacionit konfidencial.

61. Kryetarja thekson se ulja e dënimit nënkupton lirin e menjëhershëm të personit të dënuar, çka nuk mundëson vendosjen e kushteve të lirit. Duke mbajtur parasysh llojin e veprave penale për të cilat z. Gucati u dënua dhe ndikimin mjaft negativ të veprimeve të tij mbi dëshmitarë të mundshëm në të ardhmen dhe viktimat, dhe pasi ka marrë parasysh interesat e drejtësisë dhe parimet e përgjithshme të së drejtës duke u bazuar në faktet e çështjes, Kryetarja gjykon se ulja e dënimit nuk është e përshtatshme. Rrjedhimisht, Kryetarja nuk miraton uljen e dënimit të z. Gucati.

62. Pasi ka gjykuar se nuk është e përshtatshme që z. Gucati t'i ulet dënimi, Kryetarja do të vendosë nëse do të modifikojë ose ndryshojë dënimin e tij, në përputhje me nenin 51(2) të Ligjit dhe nenin 10 të Udhëzuesit të Punës.

---

<sup>68</sup> Shih më lart, para. 20-22, 25.

#### IV. MODIFIKIMI OSE NDRYSHIMI I DËNIMIT

63. Sipas nenit 51(2) të Ligjit, lexuar së bashku me nenet 3(1) dhe 10 të Udhëzuesit të Punës, kur konstaton se ulja e dënimit nuk është e përshtatshme, Kryetarja mund të vendosë ta modifikojë ose ndryshojë dënimin që i është shqiptuar personit të dënuar pasi personi të ketë vuajtur dy të tretat e dënimit. Për këtë qëllim, Kryetarja mund ta modifikojë ose ndryshojë dënimin e personit të dënuar duke urdhëruar lirimin e tij, me disa kushte konkrete. Këto kushte janë në fuqi gjatë gjithë kohëzgjatjes së dënimit me burgim që i është shqiptuar personit të dënuar, ose deri më një datë të mëhershme të caktuar.<sup>69</sup> Në përputhje me nenin 11(2) të Udhëzuesit të Punës, Kryetarja mund të vendosë të anulojë ose ndryshojë vendimin e vet nëse personi i dënuar shkel një ose më shumë prej kushteve që i janë caktuar.

64. Kryetarja gjykon se veprat penale për të cilat z. Gucati u dënua janë padyshim të rënda, duke marrë parasysh ndikimin që ka zbulimi i informacionit konfidencial dhe i emrave të dëshmitarëve të mundshëm mbi administrimin e drejtësisë. Sidoqoftë, Kryetarja konstaton se ka disa faktorë që peshojnë në favor të modifikimit të dënimit të z. Gucati me anë të lirit të tij, megjithëse me kushte.

65. Kryetarja rithekson se: (i) z. Gucati ka treguar shenja të distancimit të njëmendtë nga veprat penale për të cilat u dënua; (ii) z. Gucati ka treguar shenja pozitive të rehabilitimit; (iii) gjasat se lirimi i z. Gucati do të shkaktonte paqëndrueshmëri shoqërore të konsiderueshme në Kosovë janë të vogla; (iii) z. Gucati ka lidhje të ngushta familjare dhe shoqërore, që do ta ndihmonin riintegrimin e tij në Kosovë; dhe (iv) vështirësitë mendore që lidhen me të qenit larg familjes, veçanërisht larg nënës, e cila është në gjendje të rëndë shëndetësore. Kryetarja thekson se z. Gucati gjithashtu ka deklaruar bindshëm se do t'u përmbahet të gjitha kushteve që mund t'i

---

<sup>69</sup> Shih nenin 11(1) të Udhëzuesit të Punës.

caktohen në lidhje me lirimin.<sup>70</sup>

66. Sikurse është theksuar më herët, Kryetarja është në dijeni se në të kaluarën, z. Gucati nuk është treguar gjithmonë i gatshëm për t'u distancuar nga veprat penale për të cilat u dënua. Megjithatë, Kryetarja gjykon se gjatë vuajtjes së dy të tretave të dënimit, z. Gucati ka pasur mundësi të reflektojë për veprimet e veta dhe konstaton se sjellja e tij ka ndryshuar me kalimin e kohës. Duke marrë parasysh të gjithë faktorët, Kryetarja e vlerëson të njëmendtë keqardhjen që shprehu z. Gucati, veçanërisht faljen që ai shprehimisht u kërkoi të gjithë atyre që mund të ishin ndier të kërcënuar nga veprimet e tij, si dhe zotimin e tij se nuk do të përfshihet më në sjellje që mund të karakterizohen si vepra penale kundër administrimit të drejtësisë. Z. Gucati u shpreh se do t'i përmbushë të gjitha kushtet, përderisa të jetë në gjendje të ketë qasje në kujdes mjekësor në lidhje me një nga lëndimet e tij.<sup>71</sup>

67. Duke mbajtur parasysh sa më lart, megjithëse dënimi i z. Gucati mbetet sikurse është shqiptuar nga Paneli i Gjykatës së Apelit, Kryetarja është e mendimit se dënimi duhet të modifikohet në lirim të z. Gucati me kushte. Kryetarja thekson se kushtet që do të caktohen do t'i japin z. Gucati mundësinë që të demonstrojë se vazhdon të ecë drejt rehabilitimit të plotë dhe se do t'u përmbahet të gjitha urdhrave që mund të lëshojnë Dhomat e Specializuara në të ardhmen, sipas rastit.

68. Duke pasur parasysh sa më lart, dhe pasi ka shqyrtuar tërësinë e informacionit që i është paraqitur, si dhe mendimet e gjykatësve të paneleve që kanë shqiptuar dënimin, Kryetarja vendos se, për lirimin e z. Gucati në përputhje me nenin 11(1) të Udhëzuesit të Punës, për pjesën e mbetur të dënimit të shqiptuar nga Paneli i Gjykatës së Apelit zbatohen kushtet në vijim:

a) garancia se do të banojë tërë kohën në adresën e shtëpisë, shënuar në

---

<sup>70</sup> Parashtrimet e Gucatit, para. 40 (f. 10). Shih gjithashtu Parashtrimet e Gucatit, para. 42 (f. 10-11).

<sup>71</sup> Transkripti i seancës, 28 shtator 2023, f. 8-9.

Parashtrimet e Gucatit;<sup>72</sup>

- b) të informojë Administratoren dhe stacionin e policisë të identifikuar nga Administratorja për ndërrimin e vendbanimit të përhershëm, në varësi të miratimit nga Kryetarja;
- c) të paraqitet çdo javë në stacionin e policisë të identifikuar nga Administratorja;
- d) Administratores t'i dorëzohet pasaporta ose dokumentet e udhëtimit të z. Gucati;
- e) të qëndrojë në Kosovë dhe të informojë Administratoren në rast se dëshiron të udhëtojë jashtë Kosovës dhe kërkesa për leje për udhëtim të miratohet nga Kryetarja;
- f) të mos kontaktojë, as të komunikojë me dëshmitarë ose viktime (të mundshme) para Dhomave të Specializuara dhe ZPS;
- g) të mos japë deklarata publike drejtpërdrejt ose tërthorazi lidhur me Dhomat e Specializuara dhe ZPS-në;
- h) të kërkojë leje dhe miratim nga Administratorja për intervista me median, sikurse përcaktohet në Udhëzuesin e Punës për të Paraburgosurit (Komunikimet me Mediat);
- i) të përmbushë vendimet ose urdhrat e Dhomave të Specializuara; dhe
- j) të mos bëjë komente negative të dhunshme, frikësuese, kërcënuese ose shtrënguese ndaj ose rreth dëshmitarëve (të mundshëm) ose personave të tjerë që janë të rrezikuar për shkak të bashkëpunimit të tyre me Dhomat e

---

<sup>72</sup> Parashtrimet e Gucatit, para. 15. (f.5)

Specializuara, dhe ndaj ose rreth zyrtarëve të Dhomave të Specializuara ose të ZPS-së.

69. Kryetarja thekson se kushtet e përcaktuara më lart lidhur me lirimin e z. Gucati, mbeten në fuqi për pjesën e mbetur të dënimit prej katër vjet e tre muaj të shqiptuar nga Paneli i Gjykatës së Apelit, konkretisht deri më 24 dhjetor 2024. Kryetarja thekson gjithashtu se mospërbushja prej z. Gucati e kushteve të përcaktuara në paragrafin 68 do të rezultojë në anulimin ose ndryshimin e vendimit aktual në përputhje me nenin 11(2) të Udhëzuesit të Punës.

## V. PËRFUNDIM

70. Pas shqyrtimit të kujdesshëm të informacionit që i është paraqitur, përfshirë mendimet e gjykatësve të paneleve që kanë shqiptuar dënimin, si dhe interesit të drejtësisë dhe parimeve të përgjithshme të së drejtës bazuar në faktet e kësaj çështjeje, Kryetarja vendos se ulja e dënimit nuk është e përshtatshme. Në vend të kësaj, Kryetarja do të modifikojë dënimin e z. Gucati , për të mundësuar lirimin e tij me kushtet e përcaktuara në paragrafin 68 më lart.

71. Në këtë aspekt, Kryetarja vë në dukje se veprat penale për të cilat është dënuar z. Gucati janë të rënda dhe ndonëse ai ka treguar shenja të njëmendta të distancimit nga veprat e tij penale dhe disa shenja pozitive të rehabilitimit, është me rëndësi të sigurohet vazhdimi i rehabilitimit dhe distancimit të plotë të z. Gucati, përmes kushteve të përcaktuara në paragrafin 68 më lart. Duke marrë parasysh se dënimi modifikohet me këtë vendim, rishikimi lidhur me ndryshimin e dënimit është i tejkalluar.

## VI. VENDIM

72. Bazuar në sa më lart, Kryetarja:

**VENDOS** se ulja e dënimit të z. Gucati nuk është e përshtatshme dhe rrjedhimisht nuk miratohet;

**VENDOS** të modifikojë dënimin e z. Gucati duke e liruar me kushtet e përcaktuara në paragrafin 68 më lart;

**VENDOS** që, në varësi të organizimit të transferimit nga Administratorja, z. Gucati të lirohet më 18 tetor 2023, në vendbanimin e tij të përhershëm, në adresën e shtëpisë, shënuar në Parashtrimet e Gucati;

**URDHËRON** z. Gucati të përmbushë kushtet e përcaktuara në paragrafin 68 më lart;

**URDHËRON** Administratoren të marrë të gjitha masat e nevojshme për transferimin e z. Gucati në adresën e shtëpisë, shënuar në Parashtrimet e Gucati dhe me kushtet e përcaktuara në paragrafin 68 më lart;

**URDHËRON** policinë e Kosovës ose çdo autoritet tjetër në Kosovë që, në përputhje me nenin 51(1) të Ligjit, të bashkëpunojë me Administratoren për zbatimin e kushteve të përcaktuara në paragrafin 68 më lart dhe t'i dorëzojë Administratores raport mujor lidhur me përmbushjen prej z. Gucati të kushteve të përcaktuara në paragrafin 68(c) më lart;

**URDHËRON** Administratoren t'i raportojë Kryetares çdo muaj lidhur me përmbushjen prej z. Gucati të kushteve të përcaktuara në paragrafin 68 më lart, deri në përfundimin e dënimit të tij prej katër vjet e tre muaj, konkretisht më 24 dhjetor 2024, ose më herët në rast të shkeljes së kushteve;

**URDHËRON** Njësinë për Administrimin e Gjykatës ("NJAGJ") të riklasifikojë vendimin si publik pas konfirmimit të Administratores për mbërritjen e z. Gucati në vendin e caktuar të lirimit; dhe

**URDHËRON** NJAGJ-në të sigurojë që shtojcat e këtij vendimi të mbeten  
konfidenciale.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,**  
**Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E enjte, 12 tetor 2023  
Hagë,  
Holandë.